

MIA ■ AGJENCIA INFORMATIVE MEDIATIKE
Këshilli drejtues

Plani vjetor për parandalimin e korrupsionit
(PVPK)

i

Shoqërisë aksionare "Agjencia Informative
Mediatike" - Shkup në pronësi shtetërore (MIA)
për vitin 2023

Dhjetor, 2022

Hyrje

Korrupsioni është një nga sfidat dhe rreziqet kryesore në çdo shoqëri demokratike dhe për këtë arsye parandalimi i korrupsionit, si dhe parandalimi, janë parakusht për sundimin e ligjit, mirëfunksionimin dhe menaxhimin e institucioneve në përputhje me Kushtetutën, ligjet, normat ndërkombëtare dhe kombëtare dhe Kodin.

Siç dihet, mediat ushtrojnë veprimtari me interes publik dhe për këtë kanë autorizim publik që i detyron ta përdorin atë në përputhje me normat për autorizim të tillë. Duke marrë parasysh faktin se korrupsioni është shpërdorim i autorizimit publik për qëllime dhe përfitime personale, atëherë autorizimi publik për të informuar që kanë mediat nuk duhet të abuzohet për përfitime personale nga gazetarët dhe redaktorët në media, as të keqpërdoret nga persona të tjerë (juridik dhe fizikë) duke dhënë shpërblim ose ryshfet për mbulimin ose shtrembërimin e informacioneve.

Parandalimi i korrupsionit në media është njëkohësisht betejë për liri më të madhe të mediave dhe për rritjen e besimit të qytetarëve ndaj tyre, pra për realizimin e së drejtës për informim, nga e cila varet realizimi i të drejtave dhe lirive të tjera të qytetarëve. Kjo betejë do të jetë më efektive nëse rritet fuqia financiare e gazetarëve, e me këtë edhe mediave, të cilat përmes menaxhmentit duhet të sigurojnë paga të rregullta dhe më të larta.

1. Diagnoza e problemit

Korrupsioni në media shfaqet në formën e shpërdorimit të fuqisë tqë e kanë partitë politike (qeveria dhe opozita), biznesmenët apo autoritetet në nivel kombëtar dhe vendor për të deformuar informacionin që publikohet nëpërmjet tyre, me të cilin realizojnë interes të tyre personal apo grupor.

Detyra kryesore e Agjencisë do të jetë njohja në kohë e rreziqeve, propozimi i masave për eliminimin e rreziqeve dhe sanksionimi i autorëve. Punojmë të përkushtuar në ruajtjen e standardeve të larta ligjore, etike dhe morale, duke respektuar parimet e integritetit, objektivitetit dhe paanshmërisë dhe me mënyrën tonë të punës luftojmë kundër korrupsionit.

Fushat të cilave do t'i kushtojmë vëmendje nga rreziqe të korrupsionit janë:

- ☛ Prodhimi i lajmeve
- ☛ Planifikimi/ prokurimi publik/ i buxheti dhe zbatimi i procedurave
- ☛ Veprimi sipas denoncimit të informatorëve
- ☛ Planifikimi dhe menaxhimi financiar
- ☛ Politika e burimeve njerëzore, sjellja profesionale dhe etike e punonjësve

Aktivitetet e ndërmarra dhe në vijim

Agjencia Informative Mediatike – MIA në vitin 2017, ka miratuar Udhëzim për pranimin e raporteve nga informatorët, në përputhje me dispozitat e Ligjit për mbrojtjen e informatorëve, si dhe është caktuar një person për parandalimin e parregullsive në kontekst të Ligjit për qasje të lirë në informata të karakterit publik. MIA në vitin 2012 ka përgatitur Procedurën e sistemit për zbatimin e furnizimeve publike, Procedurën për menaxhimin e rreziqeve dhe mundësive, Udhëzuesin për kategorizimin dhe llojet e rreziqeve dhe Regjistrin e rreziqeve.

MIA do të vazhdojë të konfirmojë dhe forcojë integritetin e saj në hapësirën publike, sepse vetëm mediat me integritet dhe besim nga audienca kontribuojnë qartë dhe pa mëdyshje në luftën kombëtare kundër korrupsionit.

Menaxhmenti i MIA-s i motivon gazetarët që të rrisin prodhimin e lajmeve dhe informacioneve lidhur me korrupsionin në vend dhe në botë. Çdo lajm i publikuar për korrupsionin është luftë publike kundër korrupsionit dhe kontribut mediatik në këtë proces.

MIA, si edhe më parë, edhe tash e tutje, përveç që nuk pranon dhe dënon autocensurën, por do të kundërshtojë edhe publikisht çdo tentativë për autocensurë, arsye për të cilën ka qenë apo është presioni nga subjektet politike (qeveria apo opozita), ndikimet e biznesit dhe të tjera.

Ne në MIA jemi të vetëdijshëm se lufta serioze kundër korrupsionit është e pamundur pa pjesëmarrjen e drejtpërdrejtë të mediave si aktor i rëndësishëm në shoqëri dhe në këtë kuptim e mbështesim pa rezerva një luftë që ka nevojë për transparencë të mundësuar nga mediat profesionale dhe shumë të standardizuara siç është MIA.

2. Aktivitete për luftë më efektive kundër korrupsionit

***Mbështetje për realizimin e Kapitujve 23 dhe 24 dhe shkëmbim të përvojave ndërkombëtare**

MIA do të monitorojë dhe prezantojë dokumente (normativa, hulumtime, analiza...) të miratuara apo rekomanduara nga BE-ja për luftë më efektive kundër korrupsionit.

MIA do ta njoftojë publikun me kapitullin 23 (Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe të drejtave të njeriut) dhe kapitullin 24 (Drejtësia, liria dhe siguria) si segmente kyçe në procesin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE.

Në bazë të bashkëpunimit ndërinstitucional, si dhe anëtarësimit në asociacionet ndërkombëtare të agjencive të lajmeve, MIA do të publikojë produkte gazetareske që janë në funksion të luftës kundër korrupsionit, si dhe është e përgatitur për përgatitjen e analizave krahasuese.

Mbështetje dhe veprim ndërinstitutional në luftën kundër korrupsionit

MIA-ja për auditorin do të ofrojë lidhje direkte për navigim të shpejtë përmes ueb-faqes së MIA-s me Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit-KSHPK, dhe me zyrën e Zëvendëskryeministrit të RMV-së përgjegjës për politikën e qeverisjes së mirë, uebfaqja e MIA-s do të vendosë lidhje të drejtpërdrejtë me Ligjin Kundër Korrupsionit.

MIA do të ndikojë drejtpërdrejt në ndërgjegjësimin e publikut për luftën kundër korrupsionit dhe në këtë kuptim do të vendosë baner me navigim të lehtë në uebfaqen ku do të grumbullohen idetë, por edhe raportet për rastet korruptive apo të supozuara korruptive që mund të hetohen, përpunohen dhe publikohen në gazetari.

MIA me shenjë të veçantë do t'i bëjë të dukshme dhe të lexueshme lajmet në fushën e korrupsionit me shënimin “shtypja ndaj korrupsionit”, që do të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e besimit të qytetarët për kontributin e mediave në luftën kundër korrupsionit.

***Parandalimi - trajnime, edukim, prezantim**

MIA me potencialin e saj burimor (njerëzor dhe material) është e gatshme dhe pa probleme do të luftojë kundër korrupsionit që po gërryen themelet e çdo shoqërie demokratike.

Çdo i punësuar në MIA është i obliguar dhe në kohë do të raportojë tentativën e korrupsionit ose mbulimin e korrupsionit për interesa personale (ryshfet, mashtrim me subvencione, pastrim parash, shpërdorim besimi, kufizim i konkurrencës përmes kontratës në kontekstin e një tenderi publik, mashtrim tatimor dhe/ose zbulim i sekretit zyrtar).

MIA do të organizojë trajnime ekspertësh për edukimin kundër korrupsionit të stafit të gazetarëve për të dalluar tentativat për korrupsion dhe korrupsion ndaj gazetarëve dhe për të reaguar shpejt në situata të tilla.

Është detyrë e të gjithë të punësuarve që të veprojnë në përputhje me rregullat, procedurat, rregulloret dhe standardet profesionale të zbatuara në Agjenci, të njohin format e korrupsionit dhe të kenë aftësinë për t'i rezistuar korrupsionit.

Rezistenca institucionale ndaj korrupsionit arrihet përmes hartimit të politikave, krijimit të mekanizmave, mbështetjes për aktivitetet monitoruese, si dhe përmes edukimit të punonjësve dhe zbatimit të aktiviteteve për ndërgjegjësimin për raportimin e korrupsionit tek subjektet e mbikëqyrjes dhe tek qytetarët.

3. Efektet e Planit Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit

*Rezultatet e pritura

Plani Vjetor për Parandalimin e Korrupsionit forcon kapacitetet e MIA-së dhe vendos sistemin për funksionalitetin e saj efikas në luftën kundër korrupsionit, si dhe rritjen e besimit të subjekteve që janë subjekt i rregullimit në Agjenci.

Në plan, si rezultat i vetëvlerësimit, do të regjistrohen aktivitetet e ekspozimit të institucionit ndaj rreziqeve për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit, pra do të diagnostikohen qartë fushat prioritare që mund të gjenerojnë rrezikun e korrupsionit.

MIA, si më parë dhe tani e tutje, nuk do të lejojë heshtje, mosinformim të heshtur, informim selektiv apo jo të plotë, as afirmim të individëve dhe kompanive me imazh të dëmtuar në opinion.

📄 Fusha 1: Prodhim i lajmeve

Masa	Aktiviteti	Njësia organizative kompetente/personi i autorizua	Afati i realizimit	Indikator i përmbushjes	Implikimet financiare

1. Mbrojtje më e mirë e besueshmërisë tonë	1.1 Informim objektiv 1.2 Kontrollim i burimit origjinal të lajmit 1.3 Kujdes i përkushtuar në terminologjinë e gjuhës dhe retorikës në tekstet gazetareske , titujt dhe nëntituj	Të punësuar nëpër redaksi/redaktor	Vazhdimësi	Të bëhen përpjekje shtesë që të zbulohet cilat janë arsyet qeveritare për publikimin e lajmit	
--	---	------------------------------------	------------	---	--

2. Kontroll i fuqishëm në cilësinë e çdo lajmi	Qasja në çdo lajm sikur të jet dhe shfrytëzimi i teknikave klasike dhe konfirmimin e fakteve dhe burimin origjinal	Të punësuarit nëpër redaksi/redaktor	Në vazhdimësi	Krahas kontrollit të fakteve, nevojitet sqarim për gjërat dhe detektimin e asaj që në të vërtet është problem kryesor	
3. Vetëdije e rritur për lojërat e fshehura	3.1 Zbatimi i standardeve dhe metodave themelore gazetareske 3.2 Kontrolli i burimit dhe cilësisë duhet të bëhet para publikimit të lajmit	Të punësuarit nëpër redaksi/redaktor	Në vazhdimësi	Për shkak të përgjegjësisë që kemi ndaj publikut, por edhe për shkak të besimit dhe legjitimitetit tonë shumëvjeçar, është thelbësore të dimë se çfarë po transmetojmë	

4. Rievakuimi i kushteve tona për akses të hapur në sferën publike	1. Siguri gjatë informimit - Mjedisi ynë mediatik është gjithnjë e më kaotik dhe i mbushur me versione alternative, gjë që e bën të paqartë se çfarë është e vërtetë dhe çfarë jo. 2. Qëllimi i propagandës moderne nuk është thjesht të keqraportoje ose të promovojë një agjendë, por të shterojë opinionin kritik dhe të zhvlerësojë të vërtetën.	Të punësuarit nëpër redaksi/redaktor	Në vazhdimësi	Parandalimi i informimit të rremë dhe zhvillimi i të menduarit kritik për besueshmëri më të madhe	
--	--	--------------------------------------	---------------	---	--

5. Rikontrollimi i mënyrave në të cilat ne jo vetëm që mund të shmangim gabimet, por edhe të kontribuojmë në mënyrë aktive në përmirësimin e gjërave	Nëse shfaqen informacione të reja, gjë që është thelbësore për besueshmërinë, gabimet duhet të korrigjohen në mënyrë të dukshme	Të punësuarit nëpër redaksi/redakt orët	Në vazhdimësi	Qasja në informacionet e korrigjuara në ueb faqe	
---	--	--	------------------	---	--

☐ FUSHA: 2. Prokurimi publik/ Planifikimi i buxheti dhe zbatimi i procedurave

Masa	Aktivitetet	Njësia organizative kompetente/pe rsoni i autorizua	Afati i realizimit	Indikator i përmbushjes	Implikacion e financiare
1. Planifikimi adekuat i furnizimit publik	1.1 Dorëzim i propozimeve për nevojat e prokurimit publik nga njësitet organizative me qëllim të përgatitjes së një plani vjetor për prokurimin publik	Të gjitha njësitë organizative	Në vazhdimësi	Frekuenca e ndryshimeve në Planin e Prokurimit Publik gjatë vitit	

2 Përdorimi ekonomik, efikas dhe efektiv i fondeve të destinuara për zbatimin e procedurave për ndarjen e kontratave të prokurimit publik.	2.1 Vlerësimi real i vlerës së çdo kontrate të prokurimit publik duke llogaritur shumën totale për realizimin e kontratës	Të gjitha njësitë organizative	Gjatë përgatitjes së planit vjetor për prokurimin publik dhe para fillimit të një procedure të veçantë	Procedurat e zbatuara për ndarjen e kontratave të prokurimit publik brenda mjeteve të parashikuara	
--	---	--------------------------------	--	--	--

3. Shpenzimi transparent i mjeteve të parashikuara për realizimin e prokurimeve publike dhe kontrolli në prokurimet publike	3.1 Publikimi i procedurave të prokurimit publik dhe kontratave të prokurimit publik në ueb faqen e MIA-s	Spektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing	Në vazhdimësi	Qasje në informacionet në faqen e internetit	
4. Respektim i dispozitave ligjore dhe procedurat e parapara interne për furnizime publike	4.1 Revizion vjetor nga një shtëpi revizioni	Shtëpi e pavarur revizioni e angazhuar nga MIA	Gjatë vitit 2023	Rezultatet në raportin e shtëpisë së revizionit	

5. Intensifikimi i procedurave për kontrollin paraprak të tregut, gjegjësisht zhvillimin e dialogut teknik sa herë që bëhet blerje mbi 50.000 euro, në kundërvlerë në denarë, me qëllim të rritjes së numrit të ofertuesve.	5.1 Bëhet inspektim paraprak i tregut për të parandaluar përqendrimin e operatorëve ekonomikë. Kontrolli paraprak bëhet gjithmonë për blerjet me vlerë më të madhe se 50.000 euro, në kundërvlerë në denarë.		Në vazhdimësi	Kompanitë marrin pjesë në dialogun teknik	
	5.2 Bëhet inspektimi paraprak i tregut dhe dialogu teknik me qëllim të rritjes së numrit mesatar të ofertuesve në procedurat e SHA MIA.		Në vazhdimësi	Rritje graduale e numrit të ofertuesve të SHA MIA	

2.1 Zbatimi joadekuat i procedurave të prokurimit publik

Masa	Aktiviteti	Njësia organizative kompetente/ personi i autorizuar	Afati i realizimit	Indikatorë të përmbushjes	Implikimet financiare
1. Përorcimi i kapaciteteve të personave që përgatisin specifikimet teknike	1.1 Krijimi dhe zbatimi i trajnimeve për zbatimin e standardeve në përgatitjen e specifikimeve teknike dhe kritereve për përcaktimin e	Spektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing	Në vazhdimësi	Numri i trajnimeve të zbatuara	

	aftësisë për punonjësit në njësitë organizative të Shërbimit Profesional që përgatisin specifikimet teknike në përputhje me renditjen e prokurimit publik.				
2. Parandalimi i ndikimit tek personat që përgatisin specifikimet teknike të procedurave të prokurimit publik	2. Transparencë më e madhe në zhvillimin e specifikimeve teknike përmes shqyrtimit paraprak të tregut dhe zbatimin e dialogut teknik aty ku është e përshtatshme	Spektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing	Në vazhdimësi	Procedurat e zbatuara me sukses për ndarjen e kontratave të prokurimit publik	
3. Parandalimi i ndikimit tek anëtarët e Komisioneve të Prokurimit Publik	3.1 Raportimi i përpjekjeve për të ndikuar te anëtarët e Komisioneve të Prokurimit Publik	Të gjithë anëtarët e emëruar të Komisioneve të Prokurimit Publik	Në vazhdimësi	Numri i raporteve të dorëzuara te personi i autorizuar	
	3.2 Dhënien e deklaratave për mosekzistim të përplasjes së interesave	Të gjithë anëtarët e emëruar të Komisioneve të Prokurimit Publik	Në vazhdimësi	Kur anëtarët e Komisioneve të Prokurimit Publik kanë dhënë deklarata të pasakta për ekzistencën e konfliktit të interesit	

Masa	Aktiviteti	Njësia organizative kompetente/	Afati i realizimit	Indikator të përmbushjes	Implikimet financiare

		personi i autorizuar			
1 Zbatimi adekuat i Ligjit për mbrojtjen e informatorëve, akteve nënligjore dhe udhëzimeve për pranimin e raporteve nga informatorët, ndarjen dhe përpunimin e të dhënave nga raportet dhe marrjen e masave për të siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhëna tjera	1.1 Veprim në kohë dhe ligjor pas raporteve të dorëzuara nga raportuesit 1.2 Njoftim për masat e ndërmarra të dorëzuesve të raporteve në afatin e paraparë ligjor	Personi i autorizuar për pranimin e raporteve nga informatorët	Në vazhdimësi	Përgjigjet e dorëzuara dhe masat e marra pas raporteve të dorëzuara	

FUSHA: 3. Veprimi sipas raporteve të informatorëve

2. Ngritja e vetëdijes së personave të punësuar në MIA për mundësitë e veprimit sipas Ligjit për mbrojtjen nga informatorëve, ndarjen dhe përpunimin e të dhënave nga raportet dhe marrjen e masave për sigurimin e mbrojtjes së të dhënave personale dhe të dhënave të tjera të MIA-s.	Njohja e të punësuarve të MIA-s me Ligjin për mbrojtjen e informatorëve dhe udhëzimin për pranimin e raporteve nga informatorëve	Personi i autorizuar për pranimin e raporteve nga informatorët	Në vazhdimësi	Numri i raporteve të paraqitura nga informatorët e punësuar	
---	--	--	---------------	---	--

 FUSHA: 4. Planifikimi dhe menaxhimi i financave

Masa	Aktiviteti	Njësia organizuative kompetente/personi i emëruar	Afati i realizimit	Indikator i përmbushjes	Implikimet financiare
1. Planifikimi dhe zbatimi adekuat i buxhetit	1.1 Planifikimi i buxhetit vjetor sipas nevojave reale 1.2 Transparenca e shpenzimit të fondeve të parashikuara	Të gjitha njësitë përkatëse organizative në Shërbimin Profesional	Në vazhdimësi	Dorëzim i anekseve nga sektorët dhe shërbimi për revizion të brendshëm deri te Sektori i punëve financiare dhe logjistikës me qëllim të	

	në planin financiar			përgatitjes së planit financiar Publikimi i Planit Financiar dhe Raporti Vjetor për punën në faqen e internetit	
2. Planifikimi adekuat i burimeve financiare lidhur me aktivitetet	Vlerësim i burimeve aktuale financiare për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, IT dhe shërbime dhe shpenzime të tjera	Sektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing		Janë siguruar mjete të mjaftueshme për realizimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara	
3. Transparenca e shpenzimeve të realizuara	Përgatitja e raportit për mjetet e realizuara	Sektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing		Është përgatitur dhe dorëzuar Raporti mbi mjetet e realizuara Financiare	

📌 FUSHA: 5. Politika e personelit, sjellja profesionale dhe etike e të punësuarve

Masa	Aktiviteti	Njësia organizative kompetente/personi i autorizuar	Afati i realizimit	Indikator të përmbushjes
1. Punësimi i bazuar në një sistem vlerash dhe kriteresh cilësore	1.1 Punësimi në përputhje me rregulloret ligjore pozitive dhe aktet e brendshme	Komisioni për realizimin e një konkursi punësimi	Në vazhdimësi	Intervista/testime/raporte të kryera të Komisionit për zbatimin e konkursit për punësim

2. Transparencë në procesin e punësimit	2.1 Rritja e qasjes dhe publicitetit të shpalljeve të punësimit	Spektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing	Në vazhdimësi	Publikimi i shpalljeve të punësimit në gazetën e përditshme dhe në faqen e internetit
3. Respektim konsekuent i rregullave profesionale, etike dhe institucionale të funksionimit	3.1 Edukimi i të punësuarve për të rritur integritetin dhe profesionalizmin në operacione, me theks të veçantë për personat e sapo punësuar	Spektori për çështje të përgjithshme, juridike, financiare dhe marketing	Në vazhdimësi	Distribucioni i aktëve të brendshme të vlefshme, kodeve dhe dispozitave deri te të gjithë të punësuarit sipas nevojës është trajnime speciale

SHA “MIA” – Shkup

Dragan Antonovski,

Kryetar i Këshillit Drejtues dhe drejtor i përgjithshëm